



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURËS

MINISTRI

Nr. 2432/prot
F

Tiranë, më 06.7.2018

URDHËR

Nr. 434, datë 06.7.2018

“PËR

**RIPËRTËRITJEN E LICENCËS ME KUSHT AGJENCISË “AKDIE” NË
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË ARTISTËVE INTERPRETUES
DHE EKZEKUTUES”**

Në mbështetje të pikës 4, nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, udhëzimit nr. 5166, datë 20.10.2016 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të tjera shtesë në sqarim të kriterëve të parashikuara në nenin 133, si dhe përcaktimin e kushteve dhe procedurës së marrjes së licencës ose ripërtëritjen e saj, në bazë të nenit 134, të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; si dhe kërkesës së agjencisë “AKDIE” për ripërtëritje të licencës nr. 2432 prot., datë 11.4.2018, Urdhërit të Ministrit të Kulturës nr. 205, datë 4.4.2018 “Për ngritjen e grupit të punës, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për licencim /ripërtëritjen e tyre në fushat e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to në administrimin kolektiv në përputhje me kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, ndryshuar me Urdhrin nr. 228, datë 17.4.2018 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 205, datë 4.4.2018”, si dhe legjislacionin në fuqi “Për Organizatat Jo-fitimprurëse”;

U R D H Ë R O J:

1. Ripërtëritjen e licencës së agjencisë AKDIE, si agjenci e administrimit kolektiv në fushën e të drejtave të artistëve interpretues dhe ekzekutues, me afat 3 vjeçar, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij urdhri, me kushtin që të depozitohet në fondin special, në zbatim të nenit 151/9 të ligjit nr. 35/2016, shuma prej 900.000 lekë, e konstatuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit të Financës, e cila nuk i është shpërndarë titullarëve të të drejtave.
2. Në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për të drejtën e autorit, nënshkrimin e kontratave/autorizimeve individuale me të gjithë artistët që agjencia AKDIE përfaqëson.

3. Pikat 1 dhe 2, duhet të përmbushen brenda afatit 6 mujor, duke filluar nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.
4. Mosrespektimi i pikave 1 dhe 2 të këtij urdhri, brenda afatit të përcaktuar, perbën kusht për heqjen e licencës.
5. Pas botimit në Fletoren Zyrtare të këtij urdhri për ripërtëritjen e licencës, agjencia është e detyruar të kryejë pagesën në vlerën prej 300.000 lekë, e parashikuar në Vendimin nr. 33, datë 18.1.2017 "Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga Drejtoria për të Drejtën e Autorit".
6. Ngarkohet Drejtoria e të Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI
Mirela KUMBARO FURXHI

